

## **Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për Studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Çukurova, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Çukurova, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5 muaj);
- Doktoraturë (5 muaj);

### **Fushat e studimit:**

- Marrëdhënie Ndërkombëtare;
- Histori;
- Matematikë dhe Statistikë;
- Bioteknologji;
- Kimi;

Për t'u njihur me katalogun e programeve të studimit ju lutem referohuni linkut:

[http://eobs.cu.edu.tr/SistemDetay\\_en.aspx?OgrTurId=2](http://eobs.cu.edu.tr/SistemDetay_en.aspx?OgrTurId=2)

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Bachelor:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës turke ose angleze në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement\*

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘Learning Agreement’ tek seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*  
[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Master:**

- CV;

- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Diplomë Bachelor;
- Listë notash Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Listë notash Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës turke ose angleze në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement\*

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshkruhen në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

#### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Doktoraturë:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Diplomë Bachelor;
- Listë notash Bachelor;

- Diplomë Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht) ;
- Listë notash Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës turke ose angleze në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement\*

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë/temë të njëjtë me atë që kryeni në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët/tema t’ju njihet kur të ktheheni.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

**Afati për aplikim: 17 Janar 2019**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!